kostt kostt kostt kostt kostt kostt kostt kostt kostt kostt kostt kostt kostt kostt kostt kostt

Burimet Njerëzore në KOSTT sh.a

Në suksesin e KOSTT sh.a, rolin më të rëndësishëm e luajnë punëtorët e kompanisë.

Numri aktual i punëtorëve në KOSTT është 201, prej të cilëve 79.1% të punësuarve janë meshkuj, ndërsa 20.9 % janë femra, ndërkaq mosha mesatare e të punësuarve në KOSTT është 43 vjeç.
Gjatë vitit 2008, përqindja e inxhinierëve në KOSTT ka qenë 40.31%.

Tarifat e shfrytëzimit të shërbimeve të transmisionit

Të ardhurat vjetore të lejuara për KOSTT sh.a vendosen nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë.

Tarifat e KOSTT caktohen për:

- shfrytëzimin e infrastrukturës së transmisionit
- operimin e sistemit dhe
- operimin e tregut

KOSTT sikurse në vitin 2006 poashtu edhe në vitin 2007 ka pasur vlerësim pozitiv në pasqyrat financiare nga auditori i pavarur.

Sistemi i transmisionit me të cilin operon KOSTT sh.a është i vogël por nyje shumë e rëndësishme e transmisionit në Ballkan dhe Evropën Jug-Lindore

KOSTT sh.a
Rr. Iljaz Kodra pn
10000 Prishtinë
Republika e Kosovës

Tel: + 381 (0) 38 501 601 5
Fax: + 381 38 500 201
E-mail: info@kostt.com
www.kostt.com

Janar 2009

OPERATOR SISTEMI, TRASMISIONI DHE TREGU SH.A.
TRANSMISSION, SYSTEM AND MARKET OPERATOR J.S.C.
OPERATOR SISTEMA, PRENOSA I TRZISTA, A.D.

Çka është KOSTT?

Është kompani publike e cila është përgjegjëse me planifikimin, zhvillimin, mirëmbajtjen dhe operimin e sistemit të transmisionit të energjisë elektrike në Kosovë.

Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut-KOSTT sh.a, është themeluar me 1 korrik të vitit 2006.

KOSTT sh.a është krijuar si rrjedhojë e procesit të ristrukturimit të sektorit të energjisë në Kosovë, në bazë të obligimeve që rrjedhin nga Traktati për Komunitetin e Energjisë për Evropën Juglindore si dhe në bazë të vendimit të Qeverisë së Kosovës të korrikut 2005 për ristrukturim të Korporatës Energjetike të Kosovës-KEK (kompani e integruar vertikalisht). Me këtë, funksioni i Transmisionit dhe Dispeçingut është ndarë zyrtarisht nga KEK-u dhe më 1 korrik 2006 është themeluar KOSTT sh.a si kompani publike e veçantë nga KEK.

I emëruar nga Qeveria dhe i liçensuar nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë në tetor të vitit 2006, KOSTT sh.a është pronare e dy liçensave:

- për Operim të Sistemit të Transmisionit
- për Operim të Tregut të energjisë elektrike.

kostt kostt kostt kostt kostt kostt kostt kostt kostt kostt kostt kostt kostt kostt kostt kostt

Misioni dhe Vizioni i KOSTT sh.a

Vizioni

Të jetë kompani profitabile, për transmetimin e sigurt dhe stabil të energjisë elektrike, e përgjegjëshme ndaj shoqërisë dhe mjedisit, e integruar në mekanizmat evropian.

Misioni

Të siguroj:

- shërbime cilësore duke implementuar të arritura tekniko-teknologjike në zhvillimin e sistemit të transmisionit;
- transparencë dhe jo-diskriminim në tregun konkurrues të energjisë elektrike;
- avancim të pozitës në nivelin rajonal dhe evropian përkrahur nga ngritja e vazhdueshme e kapaciteteve njerëzore.

Përbërja e Rrjetit të Transmisionit

KOSTT sh.a është pronare e rrjetit të transmisionit të tensionit të lartë të Republikës së Kosovës dhe aktualisht përbëhet nga 1186 km gjatësi të linjave të njëfishta, që përfshijnë 181 km gjatësi linjash te tensionit të 400 kV, 361 km të linjave të tensionit 220 kV dhe 643 km linja të tensionit 110 kV.

Përveç këtyre rrjeti përfshin edhe 2600 MVA kapacitete transformuese përkatësisht nënstacione në nivele të ndryshme të tensionit.

Sistemi Elektroenergjetik i Republikës së Kosovës



Projektet Kapitale të KOSTT sh.a

Projektet kapitale të KOSTT si më të rëndësishmet për zhvillimin dhe avancimin e sistemit të transmisionit janë:

Linja interkonektive 400 kV Kosovë-Shqipëri.

Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut-KOSTT sh.a, është themeluar me 1 korrik të vitit 2006.

- Ky projekt parashikohet të fillojë brenda vitit 2009 dhe kohë zgjatja e implementimit është 36 muaj, deri në fund të vitit 2011;

Paket Projekti TS 400/110 kV – Peja 3,

- Përfshin ndërtimin e një Nënstacioni 400/110 kV në Istog, bashkë me linjat ndërlidhëse 400 dhe 110 kV dhe zgjerimin e nënstacionit në Skenderaj prej 35 kV në atë 110/10(20) kV, i cili paket pritet të përfundojë në fund të vitit 2009;

SCADA/EMS dhe Telekomunikacioni

- Ky projekt është financim i Buxhetit të Kosovës, në vlerë totale prej 17.2 milion Euro dhe pritet të përfundojë në fund të vitit 2011;

Paket Projekti TS 400/110 kV Ferizaj 2

- i cili përfshin ndërtimin e një Nënstacioni 400/110 kV në Ferizaj, bashkë me linjat ndërlidhëse, dhe është planifikuar të përfundohet në vitin 2011.

KOSTT sh.a edhe në vitin 2008 ka vazhduar me traditën e përmbushjes me sukses të planit të investimeve kapitale.